



**HAL**  
open science

# **Përdhunimet masive në lufrat e Bosnjës dhe Kosovës në vitet '90: vështrim kritik mbi qasjet publike dhe shkencore ndërkombëtare**

Albert Doja

## **► To cite this version:**

Albert Doja. Përdhunimet masive në lufrat e Bosnjës dhe Kosovës në vitet '90: vështrim kritik mbi qasjet publike dhe shkencore ndërkombëtare. *Revista Politikja*, 2019, [8] (1), pp.54-70. <halshs-03820157>

**HAL Id: halshs-03820157**

**<https://shs.hal.science/halshs-03820157v1>**

Submitted on 18 Oct 2022

**HAL** is a multi-disciplinary open access archive for the deposit and dissemination of scientific research documents, whether they are published or not. The documents may come from teaching and research institutions in France or abroad, or from public or private research centers.

L'archive ouverte pluridisciplinaire **HAL**, est destinée au dépôt et à la diffusion de documents scientifiques de niveau recherche, publiés ou non, émanant des établissements d'enseignement et de recherche français ou étrangers, des laboratoires publics ou privés.



HAL Authorization



# politikja

Revistë Shkencore

Departamenti i Shkencave Politike

1/2019

## Shoqëria nën një perspektivë gjinore dhe feministe

Ermira Danaj

Klejd Këlliçi

Barbara Halla

Albert Doja

Liri Kuçi

Ervina Kotolloshi

Elisabeta Bajrami Ollogu

Nevila Xhindi

Blerjana Bino

Doris Pasha

Ledia Dushku

Irena Myzeqari

Tinka Kurti

Rea Nepravishta

**Albert Doja**

Akademia e Shkencave të Shqipërisë

Universiteti i Lilës, Francë

## **Përdhunimet masive në luftrat e Bosnjës dhe Kosovës në vitet '90: vështrim kritik mbi qasjet publike dhe shkencore ndërkombëtare<sup>1</sup>**

### **Abstrakt**

*Përdhunimet e grave janë një fenomen i kahershëm, gjithmonë pjesë e luftës dhe genocidit. Ato ndodhin pa dallim kombësie apo vendndodhjeje gjeografike. Duke patur parasysh shpeshësinë e këtij fenomeni dhe mungesën e efekteve të marrëveshjeve ndërkombëtare, lind pyetja pse dhe cili është funksioni i përdhunimeve në luftë. Rastet e përdorimit sistematik të përdhunimit dhe dhunës seksuale kanë shumë arsye dhe shpjegimet mbi to janë po ashtu të shumëllojshme. aq më tepër kur kohët e fundit, kjo çështje ka tërhequr vëmendjen e studiuesve të shumë disiplinave. Megjithatë, shumë studiues mbeten të kufizuar në studimin e modeleve të përdhunimeve që variojnë shumë për nga fushëveprimi, gjerësia, qëllimi dhe format ndërmjet dhe brënda konflikteve<sup>2</sup>. Disa prej tyre kanë naivitetin të përdorin matje statistikore të cilat përmbajnë një mori shpjegimesh për variabilet, duke përdorur përafrimet më të mira të mundëshme<sup>3</sup>. Ndërmjet modeleve kryesore të shpërndarjes shkakësore dhe përfaqsimit, mund të vihen re shumë shtresëzime shkakësore. Nuk është se vetëm seksualiteti dhe dhuna shfaqen bashkë në kohë të vështira, porse përdhunimet masive dhe sulmet seksuale duket se shfaqen në forma standarte.*

### **Hyrje**

Përdhunimi mund të analizohet përmes efekteve që ka mbi dinamikën e grupit mashkullor, rangut ushtarak, formacioneve etno-shtetërore, formave politike të rekrutimit, riorganizimeve familjare, marrëdhënieve gjinore, dallimeve ekonomike dhe rurale/urbane, si dhe formave të rekrutimit apo pastërtisë papastërtisë fetare. Konfliktet me në qendër përdhunimin dhe konfliktin gjinor janë çështje kritike për sigurinë njerëzore dhe një rrezik për rindërtimin dhe prosperitetin pas-konfliktual. Megjithatë këto pasoja mund të na e bëjnë më të

qartë përse përdhunimet masive vijoje në masivisht, por ato nuk na shpjegojnë përse përdhunimet ndodhin në konflikte etnike, ato nuk tregojnë gjithashtu përse përdhunimi masiv kthehet në një armë efektive të strategjive ushtarake dhe spastrimeve etnike, dhe ne dimë shumë pak çka duhet për t'i parandaluar ato. Kjo ndodh pasi shumë shpjegime nuk arrijnë të marrin parasysh konstruktet sociale të grupeve të interesit, prioritetet e sigurisë, si dhe perceptimet e asaj çka është e drejtë apo jo e që vjen përmes ndërveprimeve sociale, inkuadrimeve strategjike që bëjnë narrativa të caktuara. Disa prej këtyre shpjegimeve neglizhojnë t'i teorizojnë përdhunimet masive si shenjues kryesore apo si çështje të sigurizimit në kategoritë si gjinia, etnia dhe shteti. Ato përjashtojnë veçanërisht dimensionin strukturor të instrumentit të përdhunimit sikurse ilustrohet në rastin e konflikteve të tmerrshme etnike në ish-Jugosllavi, gjë që mund të na ofrojë një orientim më produktiv mbi kulturën publike në raport me qasjen politike.

Me shpërthimin e luftës në ish-Jugosllavi, në fillim të viteve 1990, përdhunimi u bë një temë e rëndësishme që meritonte vëmendje të veçantë nga studiuesit, sidomos në raport me ato aspekte të gjinisë dhe seksualitetit që lidhen me etninë. Ndërsa burrat nga të gjithë grupet etnike kryenin përdhunime, raportet mbi dhunën seksuale gjatë Luftës së Bosnjës (1992-1995) dhe Luftës së Kosovës (1998-1999), të kryera nga ushtarët dhe paramilitarët serbë janë konsideruar si tejet alarmantë.<sup>4</sup> Shumë prej modeleve të dhunës, drejtuar civilëve jukej se konfirmonin analizat feministe të vulnerabilitetit të grave në konfliktet etno-nacionaliste. Dhuna me objektiv gratë solli dhe njëherë përdhunimet e luftës të qendër të vëmendjes së botës. Që prej asaj kohe, përdhunimet janë më të pranishme në disa tipe konfliktesh, sidomos konfliktet etnike, gjenocidet, lëvizjet secesioniste, si dhe shoqërohen me forma të tjera dhune.

Një faktor i rëndësishëm që ndikon në ndjeshmërinë publike mbi masën e përdhunimeve dhe mizorive seksuale gjatë konflikteve etnike në ish Jugosllavi kanë qenë ritur aktivitetin e gazetarëve, punonjësve humanitarë, studiuesve të feminizmit të lidhje me mobilizimin ndërkombëtar në favor të viktimave boshnjake të dhunës seksuale. Një prej analizave kryesore feministe mbi përdhunimin ishte një përmbledhje punimesh,<sup>5</sup> që përfshinte një sërë zërash feministë, bashkë me artikuj gazetash, simpoziume e libra.<sup>6</sup> Ato u përqëndruan tek përdhunimi si armë lufte, një instrument gjenocidi, një motor lufte, taktikë lufte e kështu me radhë. Këto shprehje reflektojnë idenë se dhuna seksuale ka qenë sistematike, e udogjendur, e qëllimshme, apo si e orkestruar zyrtarisht në funksion të vijimit të qëllimeve militariste, maskiliste dhe /apo nacionaliste me qëllime sikurse ai i shkatërrimit të komunitetit.<sup>7</sup> Të gjitha theksojnë se përdhunimet nuk janë thjeshtë fakte të rëndomta, por duken sikur janë pjesë e një politike të qëllimshme<sup>8</sup>. Në këtë kontekst, përdhunimi është një ngjarje politike, e lokalizuar në agjendat militariste dhe nacionaliste e që kërkon analizë dhe veprim substancial.

Në konfliktet më të militarizuara, përdhunimi shërben si strategji për të frikësuar, të ulur, poshtëruar, ndëshkuar, dhe torturuar, me qëllim hakmarrjen dhe zhburrërimin e armikut. Në disa raste, përdhunimi është preludi i vdekjes. Në raste të tjera, përdhunimi mund të jetë një taktikë e një grupi secesionist me synim fundin e marrëdhënieve mes dy grupeve,<sup>9</sup> ose si pjesë e një fushate më të gjerë spastrimi apo asgjësimi etnik, që synon zhbërjen e komuniteteve dhe detyrimin e civilëve të lënë territorin, në mënyrë që tjetri të vendosë dominimin etnik dhe atë politik. Në shumicën e rasteve, përdhunimi përfshin performance detyruese të kriminelit dhe viktimës të cilët duhet të kryejnë ritualet publike të poshtërimit përpara të tjerëve të rëndësishëm.

## **Përdhunimi dhe të drejtat e njeriut**

Në fushatën mbarëbotërore kundër dhunës ndaj grave, çështja e përdhunimeve në lufrat jugosllave, inkuadrohet si një sulm e metodë spastrimi etnik ndaj individëve dhe kolektivitetit, e që shfaqet si një kondensim simbolesh, të afta të evokojnë emocione të thella e të provokojnë përgjigje të ngjashme.<sup>10</sup> Argumentet feministe mbi njohjen e përdhunimit si armë lufte ka gjetur së fundmi terren ligjor, element esencial në themelimin e Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet në ish-Jugosllavi,<sup>11</sup> e që ka trajtuar menjëherë këto abuzime. Kjo Gjykatë ad-hoc i detyrohet shumë aktivizmit dhe përpjekjeve feministe që patën shumë influencë, në përcaktimin e përdhunimit si krim dhe më specifikisht si krim ndaj njerëzimit,<sup>12</sup> duke i dhënë më shumë vizibilitet politik praktikës së përdhunimit sistematik si instrument spastrimi etnik dhe gjenocidi.

Sidoqoftë, përpjekjet për të mbrojtur të drejtat njerëzore të grave dhe presioni ndërkombëtar i institucioneve janë manipuluar kryesisht nga qeveritë lokale, politikanët dhe nacionalistët, por edhe nga gazetarët lokalë dhe ndërkombëtarë si dhe mediat. Një prej aspekteve më shqetësuese të përdhunimeve të luftës në Jugosllavi, është mbulimi i tejjgjërë mediatik që shoqërohet nga raportime sensacionale mbi përdhunimet sistematike, dhunën seksuale dhe mizoritë e tjera të luftës, e që kanë si qëllim më shumë amplifikimin e etheve nacionaliste se sa ndihmën për gratë e traumatizuara. Për shumë arsye, politikja, përditshmëria politike, roli i tepruar i mbulimit të mediave dhe teknologjisë moderne në mbulimin e luftës etnike në ish Jugosllavi, përfshi këtu dhe përsëritjen e praktikave të njëjta në Kosovë, u përhapën me shpejtësi në gati të gjithë vendet perëndimore. Padyshim, shumë u preokupuan për faktin se disa prej këtyre mbulimeve mediatike dukeshin sikur kishin fituar një jetë të vetën, duke krijuar një lloj histerie që është larg nga eksperiencia e viktimave individuale.

Mediat perëndimore akuzohen shpesh se kanë një orientim vuajerist

kundrejt përdhunimeve.<sup>13</sup> Mobilizimi i komunitetit ndërkombëtar mund t'i ketë vendosur gratë e dhunuara përballë formave të reja të poshtërimit nga mediat, apo për të përdorur një shprehje famëkeqe, duke kthyer përdhunimin në pornografi.<sup>14</sup> Mbi këtë nuk ekzistojnë vetëm thashethemet mbi ekzistencën e videove të përdhunimeve që qarkullojnë në rrjetin ndërkombëtar të pornografisë por edhe shakatë e gazetarëve amerikanë apo historitë apokripte që konfirmojnë horrorin e kundrimin vuajerist të perëndimit. Aktivistët raportnin se gazetarët perëndimorë u dyndën në kampet e rrefugjatëve duke u ofruar shuma të mëdha parash grave për të treguar historitë e tyre në shtypin ndërkombëtar, apo kur organizata të mëdha të lajmeve dërgonin fakse për të kërkuar intervista nga gratë në kampet e përdhunimit në ish Jugosllavi.<sup>15</sup> Një faks që kish mbërritur në Qendrën për Gratë Viktima të Luftës në Zagreb, u bë legjendë: “[kërkohet] Grua boshnjake e përdhunuar, mundësisht me barrë dhe anglisht folëse, kërkohet shumë.”<sup>16</sup>

Ajo çka është më e rëndësishmja, sikurse kam treguar dhe më parë,<sup>17</sup> disa studiues kanë anuar po ashtu kaj një lloj vuajerizmi gati intelektual dhe me trajta eurocentrike. Në qasjen e tyre, ato preferojnë aspektet impulsive dhe estetike tregimit të përdhunimeve gjatë luftës në Bosnje, pasi si në luftë si jashtë saj, fakti më i rëndësishëm për ta nuk është realiteti sociologjik i luftës si një fushë mizorish, por si një mizori që është pika kulmore e produktit estetik.<sup>18</sup> Referencat mbi estetikën në kontekstin e mizorive janë gjithmonë të pakëndëshme dhe ngrenë përvitueshmërisht pyetje mbi etikën dhe dinamikën e pasqyrit të pushtetit, potencialit sensacionist, përvetësimin dhe errësimin ideologjik, dhe rrezikun e ri-traumatizimit dhe rishfaqjen tek viktimat e akteve që pasqyrojnë traumën.

Reportazhet televizive të përdhunimeve në edicionet e lajmeve të mbrëmjes u përdorën nga media nacionaliste si një armë në luftën propagandistike, por ka gjithashtu dhe të dhëna se disa gra në Bosnje dhe në Kosovë e kanë parë vëmendjen ndërkombëtare mbi përdhunimet si privim të personalitetit dhe përfaqësimit të grave.<sup>19</sup> Grupet aktiviste të grave kanë diskutuar shpesh se si dokumentimi edhe përdorimi i dhunës seksuale në ish Jugosllavi është përdorur si propagandë sidomos në mediet perëndimore. Çështja e abuzimeve seksuale kundër grave është manipuluar shpesh për avantazh politik për të përhapur propagandën e luftës, e për të thelluar urrejtjen ndëretnike, për të manipuluar popullsitë perëndimore, sipas nevojave të politikës së përditshme si dhe për të rritur audiencat televizive dhe të shtypit.

---

<sup>13</sup> Allen 1996.

<sup>14</sup> MacKinnon 1994.

<sup>15</sup> Olujic 1998.

<sup>16</sup> Morokvasic 1999.

<sup>17</sup> Doja 2001.

<sup>18</sup> Nahoum-Grappe 1996: 190-191.

<sup>19</sup> Seifert 2002: 35.

Është tejet e vështirë për të kuptuar shfrytëzimin seksual dhe viktimizimin e grave në kohë lufte, për arsye të vështirësive të teorizimit të përdhunimeve në përgjithësi, të cilat mund të mbështeten në një profesionalizëm të kushtëzuar nga deformiteti, që na shpie drejt mekanizmave të mediave dhe intelektualizmit. Një pjesë e mirë e studimeve shkencore feministe ka marrë në shqyrtim mekanizmat e drejtësisë pas-konfliktuale si gjykatat ndaj krimeve të luftës, komisionet për të vërtetën/paqëtimin, marrëveshjet e paqes dhe instrumentat ligjorë ndërkombëtare si hapësira brënda të cilave normat gjinore dhe identitetet përcaktohen dhe ripërsëriten.<sup>20</sup> Periudhat pas-konfliktuale shpesh shihen si kohë ndryshimesh të mëdha në të cilat marrëdhëniet sociale dhe politike mund të rilidhen, në të njëjtën kohë këto studime na tregojnë se shpesh identitetet dhe marrëdhëniet gjinore orientohen shpesh drejt formave tradicionale, kryesisht përmes vlerësimit të gjinisë dhe dhunës së seksualizuar.<sup>21</sup>

### **Analiza dhe kritika feministe**

Analiza feministe na sugjeron se kur gratë dëshmojnë mbi vuajtjet e tyre, ato kushtëzohen nga trupi gjykues ose komisioni shqyrtues, të cilët e kufizojnë dëshminë tek ajo çka gratë mund të thonë, apo e riinterpretojnë dëshminë si histori të dhunës seksuale apo pabarazisë gjinore.<sup>22</sup> Përfundimi i sa më sipër janë disa zona të errëta në drejtësinë tranzicionale si mbi përvojën e grave në konflikt edhe mbi efektet strukturore të pabarazisë që varen nga dhuna massive. Kritikat feministe të studiuesve të drejtësisë theksojnë veçanërisht mënyrat përmes të cilave institucionet e drejtësisë tranzicionale ngulmojnë të lidhin identifikimin e viktimave me gratë dhe gratë me dhunën seksuale si dhe të identifikojnë marrëdhënien e komplikuar mes asaj se si identifikohet dëmi dhe si vendosen pozitat e subjekteve në mekanizmat e drejtësisë pas-konfliktuale që identifikojnë veçanërisht gratë si tipologji të veçanta viktimash.

Gjykatat ndërkombëtare dhe institucionet e drejtësisë tranzitore kanë njohur tashmë se gjinia dhe pabarazia gjinore prodhojnë një formë të veçantë dhune dhe viktime të gjinizuara në periudha konfliktualiteti ekstrem,<sup>23</sup> e që janë jashtëzakonisht shkatërrimtare e një 'fat më i keq se vdekja' për gratë e shoqërive tradicionale. Cilësimi dhe pranimi i formave të gjinizuara të lëndimit mund të kenë një dimension performativ të rëndësishëm që sinjalizon dënimin ndërkombëtar të dhunës ndaj grave, e që ka qenë një element i rëndësishëm i objektivave feministe politike e juridike, parë kjo si pjesë esenciale e rindërtimit tranzitor të rendit politik e shoqëror. Sidoqoftë, përgjatë viteve 1990, konsensusi ndër feministet

20 Charlesworth dhe Chinkin 2000; Halley 2009.

21 DiLellio 2016; Farnsworth 2011; Subotic dhe Zaharijevic 2017.

22 Dembour dhe Haslam 2004; Ross 2010.

23 McGlynn dhe Munro 2010.

mbi një përfigurim të përbashkët të pikëpamjeve, repertorit të argumenteve dhe agjendës së reformave, nuk ka patur, sikurse mund të pritej, një orientim liberal që mund të bënte ndarjen mes pozicioneve ideologjike feministe të majta dhe atyre konservatore. Përkundër, forma e re organizative e stilit dhe kapaciteti feminist ka evoluar drejt “qeverisshmërisë feministe”,<sup>24</sup> një term i përdorur për të identifikuar format komplekse përmes të cilave aktivizmi jo-qeveritar është huazuar nga feministët për të arritur interesa specifike sociale që infiltrohen në shtet përmes sugjerimeve jo-shtetërore për angazhim politik me ligjin dhe format e reja të qeverisjes. Konsensusi paraprak dhe stili koalizues që kanë adoptuar formacionet feministe ka lënë shteg për radikalizmin feminist i cili mbështetet në dikotominë e sundimit për të kuptuar dominimin mashkullor e nënshtrimin femëror.

Në një qasje dikotomike feministe, e etiketuar padrejtësisht me cilësimin e çuditshëm si “feminizmi strukturalist”, studiuesit dhe aktorët ngrenë hipotezën se një dallim burrërore/femërore vlen në disa fusha të marrëdhënieve njerëzore kur burrëroja është superiore ndaj femërores. Në këtë mënyrë ata duket se e thjeshtëzojnë së tepërmi problemin duke folur në emër të të gjithë grave.<sup>25</sup>

Më konkretisht, feministet e reja radikale mendojnë se gratë janë një grup i veçantë njerëzor i cili kërkon një mbrojtje të veçantë. Ambicja e tyre është të përdorin pushtetin sovran të rendit ndërkombëtar ligjor për të prodhuar rezultate absolute, pasojat e të cilave nuk janë paralajmërimi dhe parandalimi por fundi i pandëshkueshmërisë, duke vendosur theksin mbi kriminalizimin, vënien nën akuzë dhe ndëshkimin. Gjatë viteve 1990, këto feministe zbuluan se si të përdorin orientimet e tyre dikotomike mbi atë se përdhunimi nuk ishte thjeshtë një mekanizëm i forcave ndërluftuese por pjesë e një lufte globale ndaj grave. Kur reformat ligjore ndërkombëtare filluan të marrin formë, një tjetër ide feministe u shfaq, në bazë të së cilës rendi dhe e drejta ndërkombëtare që lidhet me konfliktet e armatosura mund të ishin në favor të grave, jo si një grup i caktuar njerëzor, por si një univers në vetvete.<sup>26</sup> Ky lloj universalizmi feminist bëri të mundur që shpërthimi i konflikteve etno-nacionaliste në ish-Jugosllavi, të shihej si një luftë kundër grave, e që shoqërohej nga një indiferencë e theksuar ndaj çdo lloji vuajtje dhe vdekje që kishin pësuar burrat, duke riprodhuar një logjikë të kundërt morale me atë çka kërkonte të kundërshtonte.

Studiuesit feministë të sigurisë ndërkombëtare kanë shkruar gjerë e gjatë mbi rëndësinë e mizogjinisë maskiliste të rivlerësuar. Ata kanë theksuar masën përmes së cilës ruajta e kohezionit të grupit dhe efektshmërisë së tij, parashikon mekanizmat instrumentalë të trajnimit mizogjiniq dhe praktikave të lidhjes që janë të rrënjësura në një kontekst më të gjerë diskursiv të organizatave të armatosura si vende të burrërores përmes dhunës dhe dhunës me karakter

24 Halley, Kotiswaran, Rebouche dhe Shamir 2018.

25 Halley 2006.

26 Campbell 2007.

gjinor.<sup>27</sup> Përdhunimi në grup përdoret shpesh si mekanizëm socializues apo si një “rit inicimi”, i cili lidh me forcë luftëtarët dhe përmirëson moralin e tyre si kriminelë. Fraksionet serbe në luftat jugosllave, e kanë përdorur përdhunimin duke e identifikuar atë si “vëllazëri në faj”,<sup>28</sup> për të qenë të sigurtë se asnjë prej luftëtarëve nuk do të braktiste njësitë ushtarake nga frika e veprimeve që kishin kryer. Studiuesit e sigurisë argumentojnë se faktorët organizativë që ndikojnë në grupet e armatosura, marrin përparësi kundrejt dinamikave individuale në dhunën ndaj civilëve.<sup>29</sup> Ky argument na tregon se presioni organizativ, që vepron përmes një sërë mekanizmash, përfshi këtu konformizmin individual ndaj normave të grupit dhe shtysën për t’ju bindur urdhrëve. Kjo ndodh pasi struktura hierarkike dhe identiteti social i grupeve të armatosura, ku anëtarët shpesh socializohen me normat hiper-maskiliste dhe mizogjinike të grupit, promovojnë dhunën seksuale kolektive.

Përpjekje të ngjashme për të kuptuar dhunën masive jashtë konteksti të indinjatës apo kaosit dhe patologjive të tjera, rrezikojnë ta pozicionojnë atë jashtë preokupimeve njerëzore. Ndoshta është ngushëllues fakti se dhunës seksuale burrërore i referohemi si diçka tjetër nga zgjedhjet që burrat bëjnë, sidomos kur sa më sipër kufizohet tek hulumtimi i ideologjisë mashkullore, një kontingjencë psiko-fiziologjike, apo nënprodukt i një psikobiologjizmi me orientim seksual.<sup>30</sup> Këto qasje mund të ushtrojnë një farë tërheqje imediate pasi qartësojnë atë përse burra të zakonshëm kthehen në përdhunues, por ato janë tejet dyshuese dhe gjerësisht të diskredituara, edhe pse mund të ndodhë që ato të konfirmohen si nga viktimat dhe nga autorët e kriminit.<sup>31</sup> Nëse sa më sipër është një nevojë imediate apo jo për shpjegim, dhe çfarë pasojash ajo ka, me shumë gjasa varet nga kushtet shoqërore apo konstruksionet dominante të seksualitetit në një kohë dhe vend të caktuar, e që në anë tjetër mund të kenë impakt të gjerë në psikën dhe balancën emocionale të individit.

Nuk ka asnjë çudi që kanë qenë studiueset feministe ato që kanë përgatitur një terren të favorshëm për këtë qasje a-historike.<sup>32</sup> Që prej fillimit, ato e kanë përcaktuar përdhunimin si “një proces të ndërjegjishëm frikësimi përmes të cilit të gjithë burrat i mbajnë gratë në gjëndje frike”,<sup>33</sup> duke argumentuar se dhuna kolektive seksuale e ‘terrorit të luftës’ është shprehja më e pastër e pushtetit të burrave ndaj grave, si emblemë e një politike gjinore që ka si qëllim depersonalizimin e grave. Kjo qasje standarte dikotomike, që identifikohet me

27 Cohn 2013; Sjoberg 2010.

28 Diken dhe Laustsen 2005: 112.

29 Loken 2017.

30 Ellis 1989; Sanday 1981.

31 Jewkes, Penn-Kekana dhe Rose-Junius 2005.

32 Rejali 1996.

33 Brownmiller 1975.

shkollën amerikane feministe, shihet si arsye e mjaftueshme për ekzistencën e fenomenit dhe zhvillimit të ideologjive të dhunës që i mëshojnë mashkulloritetit mizogjinist.

Feministe të shquara perëndimore kanë shtrirë teorizimin e tyre drejt përdhunimeve të luftës dhe atyre gjenocidiale, por ato kufizohen virtualisht në lokalizimin e përdhunimeve në marrëdhëniet burrë/grua.<sup>34</sup> Ato mund të arrijnë deri te përfundimi se përdhunimi nuk ka natyrë seksuale por është një akt agresiv apo e përshkruajnë përdhunimin si “pseudo-seksual” apo “anti-seksual”, që nuk ka të bëjë fare me seksualitetin por me ushtrimin e dhunës seksuale drejtuar ndaj grave. Në të njëjtën linjë me qasje të tjera të vjetra me orientim kah seksualja, përdhunimet konsiderohen se janë pasojë e frustrimeve mashkullore seksuale në shoqëritë pre industriale ku seksualiteti është fort i disiplinuar. Në këtë kontekst, seksualiteti mashkullor përcaktohet dhe njëherë si një konstante a-historike, e cila ndjek ‘reduksionizmin hidraulik’, një teori që përdor metaforën e tenxheres me presion.<sup>35</sup>

Sipas këtij argumentimi jo konvencional, që mbështetet dhe nga disa antropologë të psikobiologjisë, shprehja dhe realizimi i shtysave të pakontrolluara seksuale të meshkujve, kontrollohet nga ndëshkime shoqërore, por se shpërthen apo del në pah nga mundësitë që ofron lufta. Përdhunimet ushtarake “mund të jenë çlirimi i imperativëve biologjikë të palejuara të një dëshire absolute dhe shkatërrimi, e cila pason rritjen e pushtetit individual mbi të tjerët”.<sup>36</sup> Për feministet radikale, burrat e përfshirë në luftë, edhe pse luftojnë në anë të kundërta të barrikadës, ndajnë të njëjtin mendim për përdhunimin, prostitucionin, pornografinë dhe vrasjet seksuale, si ekkses pasioni në kohë paqe apo si plaçkë fitoreje në kohë lufte.

Në analizë të fundit ata refuzojnë të marrin parasysh se përdhunimi ka kuptim politik, jo vetëm atëherë kur është krim i burrit ndaj gruas, por edhe atëherë kur ai lidhet me gjenocidin si krim kundër një grupi, të cilit gratë i përkasin. Ironikisht, disa feministe kanë prirje të përmbysin përdorimin politik që i bëhet përdhunimit si instrument i spastrimit etnik dhe gjenocidit, thjeshtë sepse ato mendojnë se me këtë lloj argumentimi gratë do të pushojnë së konsideruari si individë e kështu “do të shkatërrohet solidariteti transkombëtar i grave të cilat janë më pak të prirura se burrat të identifikohen me Kombin” e grupit të tyre etnik,<sup>37</sup> Po kështu, studiues të të drejtave të njeriut e konsiderojnë si problematike gjuhën e spastrimeve etnike dhe gjenocidit në ish-Jugosllavi dhe mundohen të minimizojnë politikën instrumentale të përdhunimeve masive, thjeshtë se besojnë që ky konkluzion do të kishte një efekt shkatërrues mbi të drejtat njerëzore të

34 Enloe 1993.

35 Seifert 2002.

36 Littlewood 1997: 100.

37 Morokvasic 1998: 80.

fëmijëve të lindur nga këto përdhunime.<sup>38</sup>

Këto pretendime nënvlerësuese nuk mund të shpjegojnë përdhunimet masive në kontekstin e luftës, sikurse në luftën e Bosnjës dhe të Kosovës në ish-Jugosllavi apo gjetkë. Ato prirën të harrojnë argumentime më gjithëpërfshirëse, si ato që marrin parasysh se marrëdhëniet gjinore dhe të drejtat e njeriut puqen me marrëdhënie të tjera sociale dhe politike dhe se identitetet gjinore janë pjesë përbërëse e identiteteve të tjera. Ato injorojnë veçanërisht analizat antropologjike feministe mbi atë se si përdhunimi ishte një armë e gjenocidit ndaj grave bash si individë dhe si anëtare të grupeve etnike specifike.<sup>39</sup>

Për më tepër, këto interpretime anashkalojnë punën e madhe në këtë fushë të studiuesve të antropologjisë dhe kritikës normative feministe që historicizojnë lëvizjet dinamike të gjinisë dhe marrëdhënien e tyre me dhunën politike. Nëse gratë nga të gjitha anët vuajnë si viktima përdhunimi, nuk duhet anashkaluar fakti se përdhunimi u përdor dhe u përjetua në mënyra të ndryshme si armë lufte dhe instrument gjenocidi, në varësi të historive lokale, etnisë, dinamikave ndërpersonale dhe normave kulturore.

Rëndësia ideologjike e radikalizmit feminist dhe qasjeve të tjera a-historike është se ato marrin të mirëqenë karakterin mizogjinik esencial dhe afatgjatë të përdhunimeve gjatë konflikteve, gjë që pa dashje sendëzon faktorët organizativë dhe politikave gjinore ndër grupet e armatosura. Këto qasje mbështeten në pikëpamje esencialiste të maskilinitetit si thellësisht agresive dhe të feminitetit si thellësisht ndjesore. Ato prezumojnë se të gjithë burrat janë për nga natyra agresorë absolutë dhe kufizohen vetëm nga norma sociale dhe të gjitha gratë janë viktimat perfekte e që duhet të mbrohen nga mekanizmat ligjorë. Megjithatë, edhe mënyra e skedimit të çështjeve nga Gjykata Ndërkombëtare pretendohet se i shtrembëron tipologjitë e viktimave dhe format e krimit që definojnë viktimat në mënyrë të gjinizuar<sup>40</sup>. Më tej, fokusi tek dhuna seksuale përfundon duke përcaktuar gratë ekskluzivisht nga dhuna ushtruar ndaj trupit të tyre, duke përsëritur kështu dominimin e tyre. Kompleksiteti i dhunës zhvishet po ashtu nga 'fokusi i ngushtë gjinor si shkelje e të drejtave të njeriut', kur paraqitet tipike të 'grave viktima' të dhunës seksuale paraqiten koncepte të ngushtuara në raport me kompleksitetin e dhunës masive dhe mizoritë e kryera.<sup>41</sup>

Një ripërkufizim në terma gjinorë do të sheshonte kompleksitetin e eksperiencave të dhunës të grave dhe të burrave e do ti bënte disa prej viktimave subjekte që do të dilnin në pah në kurriz të të tjerëve. Në këto inkuadrime, burrat janë agjentë, ndërsa gratë janë viktima të dhunës seksuale dhe të pafajshme në çështjet e luftës dhe dhunës. Burrat mund të provojnë dhunë të të drejtave të njeriut por gratë provojnë abuzimin seksual, gjë që influencon akoma e më shumë mënyrat dhe format në të cilat gratë pozicionohen si të përdhunuar ose të përdhunueshme dhe përdhunimi përshkruhet si i natyrshëm apo konsekuencë e

gjinizuar e konfliktit gjenocidial mes dy palëve të polarizuara që shihen gjithmonë si etnike apo nacionaliste. Në këtë kontekst konflikti etnik në ish-Jugosllavi, pasqyrimi i fuqishëm i gruas ikonike si viktimë ka integruar “eksperienca të jetuara të grave të veçanta dhe të burrave brënda konteksteve kulturore dhe politike, me një kuptim të supozuar si universale”.<sup>42</sup> Në veçanti, një numër i madh studiuesish janë shprehur mbi natyrën konservatore, patriarkale dhe rastesisht islamike të komunitetit boshnjak, dalin në përfundime se gratë boshnjake që u përdhunuan gjatë luftave mund të përjetonin një stigmë të fortë sociale. Ky karakterizim, që gabimisht njehson Bosnjën në ish-Jugosllavi me shoqëritë muslimane në Lindjen e Mesme, është marrë pa rezerva dhe është riprodhuar në opinionin publik në vitet 1990.

Duhet vënë në dukje se edhe gjatë procesit Krstic në Gjykatën Ndërkombëtare, jetët e grave boshnjake në shoqëritë tradicionale dhe identiteti i tyre si muslimane më tepër se sa si boshnjake u bë lente kryesore përmes së cilës u kuptuan eksperiencat e tyre si viktimat e gjenocidit.<sup>43</sup> Variabilet kuptimore dhe kompleksitetet e patriarkisë siç jetohen dhe kuptohen në shoqërinë boshnjake<sup>44</sup> dhe dëshmitë e dëshmitarëve<sup>45</sup> u anashkaluan, dhe patriarkia u vendos si një universal e eksperiencës boshnjake pa nuanca ose kontekst. Në këtë mënyrë, Gjykata Ndërkombëtare del në pah si një pjesë integrale e një sistemi prodhimi të njohurive që filtron prova dhe përcakton versione zyrtare, jo vetëm mbi të kaluarën apo për marrëdhëniet politike, sociale dhe ekonomike që strukturojnë dhunën dhe efektet e saj<sup>46</sup>, por edhe mbi një konceptualizim që manifeston pabarazinë gjinore tradicionale, ndarjen etnike, dhe veçoritë kulturore si patriarkalizmi.

Përpos feminizmit kulturor pop, siç reflektohet në narrativën dhe përfytyrimet e mediave publike, ka dhe një variant tjetër ballkanik, i cili na sjell një imazh të shtrembëruar të popujve europiano-juglindorë si barbarë “urrejtës tribalë”, jashtë arsyes dhe civilizimit. Implikimi është që dhuna dhe gjenocidi janë pjesë e kulturës lokale, e kësisoj të pashmangshme në Ballkan. Shumë komentues kanë ndjekur këtë rrugë në përpjekje për të shpjeguar përdhunimet masive në terma që reflektojnë një kulturë të supozuar ballkanike që inkurajon kultin burrëror të heroizimit dhe të dhunës,<sup>47</sup> temë qëndore e së cilës bëhet dhe eksplorimi i formave ekzotike të dhunës burrërore të përdorur në ish-Jugosllavi. E kështu kemi komentet tallëse që rrjedhin prej bindjeve feministe se burrat e Ballkanit kanë dhënë prova se janë të gatshëm të luftojnë dhe vdesin për një nënndarje të veçantë të etnisë sllave, e cila përcaktohet më tutje nga diferencat

42 Zarkov 2007: 13.

43 UN International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia, IT-98-33-T (2001), IT-98-33-A (2004), <http://www.icty.org/case/krstic/4>.

44 Bringa 1995.

45 Buss 2014.

46 Buss 2014: 75.

47 Stiglmayer 1994; Allen 1996.

fetare... por gratë e Ballkanit, cilado të ishte etnia apo feja, dhe në cilëndo zonë luftimi që ato gjendeshin, u shtynë, kundër vullnetit të tyre, drejt një identiteti tjetër: Ato janë viktime të përdhunimeve gjatë luftës.<sup>48</sup>

Shoqëruar nga perspektiva nacionaliste, ndërtimi i një imagjinari deri diku unik mbi popujt e Ballkanit dhe Europës juglindore, i nënkuptuar gjithashtu nga një karakterizim i grupeve kombëtare etnike në entitete me identitete kryekëput të ndryshme.<sup>49</sup> Veçanërisht, identiteti serb u veçua nga bota e civilizuar, e u pa se kërkonte hakmarrjen e cila rridhte nga “një përzjerje gjaku ekstremizmi dhe legjendash nacionaliste”, më e rëndësishmja nga të gjitha është elementi i “kultit të çetnikut me thikë në brez”.<sup>50</sup> Paraqitja e përdhunimit si diçka e pritshme gjatë luftës do të mbështetet në konstruktin e të ashtuquajturës traditë ballkanike e cila afrohet me konstruktin e urrejtjes etnike të përjetshme dhe brutalitetit, sa kohë në Ballkan ripërsëritet historia e dhunës. Me vijimësinë historike si konstante, zbulimi i përdhunimeve masive në Bosnjë apo në Kosovë, nuk ka gjasa të trondisë themelin e këtij ligjërimi.

Një tjetër qasje ndaj dimensionit të përdhunimit në masë dhe dhunës seksuale gjatë spastrimit etnik famëkeq në ish Jugosllavi ka qenë shpjegimi i tyre në raport me kontekstin kulturor, sidomos duke përdorur konceptet e idologjisë së gjakut dhe të nderit të familjes. Këto koncepte supozohet të jenë mbështetur mbi ekzistencën e një shoqërie fisnore, mbi strukturën familjare të njohur ndryshe si zadruga në zonat sllavo-jugore, në ligjet zakonore si Kanuni në Shqipërinë e veriut, praktika patriarkale dhe zakona të tjera të egra. Për rrjedhojë, shumë komentues perëndimorë e kanë lehtë të besojnë se banorët e Europës juglindore jetëojnë sipas ligjeve të vjetra zakonore, që nuk janë thjesht të errëta por edhe të pamëshirshme.

Problemi është se nderi risillet si një sistem moral në vend që të konsiderohet si një burim politik. Në fakt, çdo referencë për mentalitetin e gjakut/nderit në lidhje me trazirat post-komuniste në Shqipëri, ose për dhunën seksuale në ish-Jugosllavi, kthehet thelbësisht në një retorikë të pastër. Sidoqoftë, siç kemi argumentuar diku tjetër, interpretime të tilla kontribuan në ndërtimin e imazhit Ballkanik të Europës Juglindore në përfytyrimet ndërkombëtare. Kjo pati implikime vendimtare në politikën globale të çështjeve rajonale, përfshirë dhe justifikimin e politikës së mosndërhyrjes në Bosnjë dhe izolimin e mëtejshëm të Ballkanit Perëndimor.<sup>51</sup> Si rezultat, këmbëngulja për sigurinë ndërkombëtare kontribuoi në instalimin e një distance politike dhe etike midis Perëndimit dhe të ashtuquajturave Lufta Ballkanike.

Leximi i përdhunimit masiv përmes prizmave të brutalitetit thelbësar

48 Brownmiller 1994: 180.

49 Hansen 2001.

50 Allen 1996: 80.

51 Abazi dhe Doja 2016; 2018.

Ballkanik dhe viktimizimit thelbësor të grave, bën të mundur pretendimin se edhe pse ishin përdhunuar shumë më tepër gra bosniake se sa gra serbe, mundej që përdhunimet të ishin kryer nga të gjitha palët.<sup>52</sup> Problemi nuk është që gratë boshnjake dhe shqiptare ishin viktimat e vetme të përdhunimit, dhe dhuna e kryer ndaj grave të tjera nuk duhet të minimizohet. Sidoqoftë, ka prova të shumta se në ish-Jugosllavi ky lloj krimi ishte kryer në shumicë dërrmuese nga forcat serbe dhe kjo u identifikua si krim kundër njerëzimit gjatë proceseve kundër forcave serbe në Gjykatën Ndërkombëtare Penale.

Për më tepër, përdorimi strategjik i përdhunimeve për qëllime politike nga ana e forcave serbe kish nisur në Kosovë që para se të dëgjohej e shtëna e parë në ish-Jugosllavi, kur viktimizimi dhe militantizmi serb gjetën vend në simbolikën e trupit të grave. Në atë kohë, aktivistët lokalë serbë në Kosovë dhe intelektualët dhe klerikët nacionalistë me qendër në Beograd filluan të bëjnë fushatë kundër një shumice në rritje shqiptare në Kosovë, duke e karakterizuar nivelin e lartë të lindjeve të shqiptarëve si një komplot agresioni seksual dhe duke pretenduar një plan gjenocid për shfarosjen e serbëve përmes përdhunimit që mbillte terror. Shumë nga pretendimet se shqiptarët mund të kishin filluar të parët luftën e përdhunimit nuk u mbështetën nga prova faktike por u kthyen në thashethemet të besuara nga ana e serbëve në Kosovë.<sup>53</sup> Sidoqoftë, ato u përdorën më vonë për të hequr vëmendjen ndërkombëtare nga politika gjenocidale serbe e përdhunimeve masive si në luftën e Bosnjës ashtu edhe në atë të Kosovës.

## Përfundime

Përkundër vizibiliteteve të shumta të dhunës seksuale gjatë luftës, disa studiuese feministe “kritike” nuk e marrin parasysh paradoksin e dukshëm të dhunës seksuale të kohës së luftës që është me e dukshme në disa kontekste dhe pothuajse e padukshme në kontekste të tjerë. Ata madje mund të anashkalojnë shqetësimet feministe se dhuna ndaj grave në kohën e luftës mbetet e padukshme për shkak të çështjeve më të rëndësishme politike, apo hedhin poshtë shpjegime lidhur me mobilizimin selektiv të narrativave të përdhunimit për qëllime të propagandës nacionaliste. Kur studiueset juriste feministe argumentojnë për një qasje alternative përmes përqendrimit “në atë që ndodh në të vërtetë gjatë situatave të përdhunimit”, duke marrë parasysh variacionet dhe përjashtimet “në një nivel detaji që vë në dukje gjithë mospërputhjet dhe kompleksitetet”, kjo nuk mund të bëjë të mundur të imagjinohet një situatë “ku përdhunimi nuk është i pashmangshëm”.<sup>54</sup> Kështu pra, problemi sociologjik që duhet të shpjegohet bëhet përvoja e hollësishme e dhunës, dhe jo vetë dhuna dhe lidhjet e saj instrumentale me gjininë dhe pushtetin, ndërkohë që përdhunimi në kohë lufte dhe dhuna seksuale relativizohen dhe përfundimisht zhduken.

Në veçanti, këmbëngulja feministe se gratë e të gjitha grupeve etnike ishin viktima të përdhunimit, e përjetësoi perceptimin dhe pozicionin se “të gjithë janë fajtorë”, i cili doli të ishte një errësim moral dhe një pozicion justifikues i përdorur nga nacionalistët serbë.<sup>55</sup> Në të vërtetë, relativizmi moral i fajit të përgjithësuar lejoi përsëri një shmangie të përshtatshme të faktit kokëfortë se të pafajshmit vuanin dhe vuajtjet u ishin shkaktuar qëllimisht. Këmbëngulja juridike për të marrë në konsideratë kompleksitetin shoqëror që formëzon përvojat individuale të gjenocidit, i cili pretendohet që fshihet prej qasjes se përdhunimi është një instrument spastrimi etnik dhe gjenocidi,<sup>56</sup> bëhet një shembull tjetër i të njëjtit relativizëm moral. Në mënyrë të ngjashme, këmbëngulja feministe për të përmbysur përdorimin politik të përdhunimit si një instrument i spastrimit etnik dhe gjenocidit thjesht sepse ky lloj argumenti supozohet se shkatërron solidaritetin transnacional të grave,<sup>57</sup> nuk është gjë tjetër veçse një lëshim imoral për të justifikuar politikën gjenocidale të nacionalizmit serb. Përsëri, insistimi humanitarist për të dalluar politikën afatshkurtër të mbarsjes me dhunë nga politika afatgjatë e shkatërrimit të komunitetit, e cila pretendohet të cenojë të drejtat njerëzore të fëmijëve të lindur nga përdhunimi i luftës,<sup>58</sup> mund të bëhet padashur një tjetër përpjekje për të njëjtin relativizëm moral.

Nga të dhënat etnografike të konfliktit etnik në ish-Jugosllavi, mund të vërehet se pretendimet e fraksioneve kundërshtarë shpesh formulohen në mënyrë të ngjashme, duke zbuluar si rregullat e lojës ashtu edhe shkallën në të cilën aktorët janë të përgatitur të kryejnë dhe të tolerojnë devijimet nga rregullat kryesore. Rishikimet e ndërsjella për krimet seksuale dhe lloje të tjera dhune kundër të drejtave të njeriut, siç ka vënë në dukje Michael Herzfeld në kontekstet e tjera,<sup>59</sup> janë dëshmi të paktën po aq të simbolikës së përbashkët sa të ndryshimeve reale në fatet përkatëse të popullatave që vuajnë luftën. Kjo bëhet veçanërisht e qartë në hetimet intime të hollësishme të angazhimit etnografik me pragmatikën e ndërveprimit shoqëror që i kthen gjykimet abstrakte morale në objekte të hetimit kritik. Në mënyrë të ngjashme, qasja historike antropologjike zbulon efektet afatgjata të lidhjeve farefisnore dhe strategjive martesore, praktikave të trashëgimisë, normave morale dhe ideologjive instrumentale. Një kombinim i etnografisë së njëkohëshme dhe antropologjisë historike me analizën strukturore mund të lejojë një qasje të re teorike dhe metodologjike për të shpjeguar efektivitetin e përdhunimeve masive si një strategji ushtarake e spastrimit etnik në ish Jugosllavi.

*Përkthyer nga origjinali anglisht: Klejd Këlliçi dhe Ermira Danaj*

55 Sells 1996.

56 Buss 2009.

57 Morokvasic 1998.

58 Carpenter 2010; Weitsman 2008.

59 Herzfeld 2001.

## Referenca

- Allen, Beverly. 1996. *Rape Warfare: The Hidden Genocide in Bosnia-Herzegovina and Croatia*. Minneapolis: University of Minnesota Press.
- Abazi, Erika dhe Albert Doja. 2016. "International Representations of Balkan Wars: A Socio-Anthropological Approach in International Relations Perspective", *Cambridge Review of International Affairs* 29 (2): 581–610.
- Abazi, Erika dhe Albert Doja. 2018. "Time and Narrative: Temporality, Memory, and Instant History of Balkan Wars," *Time & Society* 27 (2): 239–272.
- Brownmiller, Susan. 1975. *Against Our Will: Men, Women and Rape*. New York: Bantam Books.
- Brownmiller, Susan. 1994. "Making Female Bodies the Battlefield". Në *Mass rape: The war against women in Bosnia Herzegovina*, përg. Alexandra Stiglmyer. Lincoln: University of Nebraska Press.
- Bringa, Tone. 1995. *Being Muslim the Bosnian way: Identity and Community in a Central Bosnian Village*. Princeton: Princeton University Press.
- Bracewell, Wendy. 2000. "Rape in Kosovo: Masculinity and Serbian nationalism", *Nations and Nationalism* 6 (4): 563–590.
- Buss, Doris. 2009. "Rethinking Rape as a Weapon of War", *Feminist Legal Studies* 17 (2): 145–163.
- Buss, Doris. 2014. "Knowing Women: Translating Patriarchy in International Criminal Law", *Social & Legal Studies* 23 (1): 73–92.
- Campbell, Kirsten. 2007. "The Gender of Transitional Justice: Law, Sexual Violence and the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia", *International Journal of Transitional Justice* 1 (3): 411–432.
- Charlesworth, Hilary dhe Christine Chinkin. 2000. *The Boundaries of International Law: A Feminist Analysis*. Manchester: Manchester University Press.
- Carpenter, Charli. 2010. *Forgetting Children Born of War: Setting the Human Rights Agenda in Bosnia and Beyond*. New York: Columbia University Press.
- Cohen, Dara-Key. 2016. *Rape During Civil War*. Ithaca: Cornell University Press.
- Cohn, Carol. përg. 2013. *Women and Wars*. Cambridge: Polity Press.
- Copelon, Rhonda. 1994. "Surfacing Gender: Reconceptualizing Crimes against Women in Time of War". Në *Mass rape: The war against women in Bosnia Herzegovina*, përg. Alexandra Stiglmyer, 197-218. Lincoln: University of Nebraska Press.
- DeBrouwer, Anne-Marie. 2005. *Supranational Criminal Prosecution of Sexual Violence: The ICC and the Practice of the ICTY and the ICTR*. Antwerpen: Intersentia.

- Dembour, Marie-Bénédicte dhe Emily Haslam. 2004. "Silencing Hearings? Victim-Witnesses at War Crimes Trials", *European Journal of International Law* 15 (1): 151–177.
- Diken, Bülent dhe Carsten Bagge Laustsen. 2005. "Becoming Abject: Rape as a Weapon of War", *Body & Society* 11 (1): 111–128.
- DiLellio, Anna. 2016. "Seeking Justice for Wartime Sexual Violence in Kosovo: Voices and Silence of Women", *East European Politics & Societies and Cultures* 30 (3): 621–643.
- Doja, Albert. 2001. "Atrocités des conflits ethniques: paradoxes venus d'ailleurs ou sensations dans le cénacle savant", *Social Anthropology* 9 (2): 223–226.
- Ellis, Lee. 1989. *Theories of Rape: Inquiries into the Causes of Sexual Aggression*. New York: Hemisphere Publishing.
- Enloe, Cynthia. 1993. *The Morning After: Sexual Politics at the End of the Cold War*. Berkeley: University of California Press
- Farnsworth, Nicole. 2011. *1325 Facts & Fables: A Collection of Stories about the Implementation of UNSCR 1325 on Women, Peace, and Security in Kosovo*. Prishtina: KWN.
- Green, Jennifer. 2004. "Uncovering Collective Rape: A Comparative Study of Political Sexual Violence", *International Journal of Sociology* 34 (1): 97–116.
- Ginn, Courtney. 2013. "Ensuring the Effective Prosecution of Sexually Violent Crimes in the Bosnian War Crimes Chamber: Applying Lessons from the ICTY", *Emory International Law Review* 27 (1): 566–601.
- Halley, Janet. 2006. *Split Decisions: How and Why to Take a Break from Feminism*. Princeton: Princeton University Press.
- Halley, Janet. 2009. "Rape at Rome: Feminist Interventions in the Criminalization of Sex-Related Violence in Positive International Criminal Law", *Michigan Journal of International Law* 30 (1): 1–123.
- Halley, Janet, Prabha Kotiswaran, Rachel Rebouche dhe Hila Shamir. 2008. *Governance Feminism: An Introduction*. Minneapolis: University of Minnesota Press.
- Hayden, Robert. 2000. "Rape and Rape Avoidance in Ethno-National Conflicts: Sexual Violence in Liminalized States", *American Anthropologist* 102 (1): 27–41.
- Hansen, Lene. 2001. "Gender, Nation, Rape: Bosnia and the Construction of Security", *International Feminist Journal of Politics* 3(1): 55–75.
- Helms, Elissa. 2013. *Innocence and Victimhood: Gender, Nation, and Women's Activism in Postwar Bosnia Herzegovina*. Madison: University of Wisconsin Press.
- Herzfeld, Michael. 2001. *Anthropology: Theoretical Practice in Culture and Society*. Oxford: Blackwell.

- Hromadzic, Azra. 2007. "Challenging the Discourse of Bosnian War Rapes". Në *Living gender after communism*, përg. J. Johnson, Janet Elise & J. Robinson, 169-184. Bloomington: Indiana University Press.
- Jewkes, Rachel. Loveday Penn-Kekana dhe Hetty Rose-Junius. 2005. "If They Rape Me, I Can't Blame Them: Reflections on Gender in the Social Context of Child Rape in South Africa and Namibia", *Social Science & Medicine* 61 (8): 1809–1820.
- Kohn, Elizabeth. 1994. "Rape as a Weapon of War: Women's Human Rights during the Dissolution of Yugoslavia", *Golden Gate University Law Review* 24 (1): 199–221.
- Littlewood, Roland. 1997. "Military rape", *Anthropology Today* 13 (2): 7–16.
- Loken, Meredith. 2017. "Rethinking Rape: The Role of Women in Wartime Violence" *Security Studies* 26 (1): 60–92.
- McGlynn, Clare dhe Vanesa Munro. përg. 2010. *Rethinking Rape Law: International and Comparative Perspectives*. London: Routledge.
- MacKinnon, Catharine. 1994. "Turning Rape into Pornography: Postmodern Genocide". Në *Mass rape: The War Against Women in Bosnia Herzegovina*, përg. Alexandra Stiglmayer, 73–81. Lincoln: University of Nebraska Press.
- Meron, Theodor. 1993. "Rape as a Crime under International Humanitarian Law", *American Journal of International Law* 87 (3).
- Morokvasic, Mirjana. 1998. "The Logics of Exclusion: Nationalism, Sexism and the Yugoslav War". Në *Gender, Ethnicity and Political Ideologies*, përg. Nickie Charles dhe Helen Hintjens 65-90. London: Routledge.
- Nahoum-Grappe, Véronique. 1996. "L'usage politique de la cruauté: l'épuration ethnique, ex-Yougoslavie, 1991- 1995". Në *De la violence*, përg. Françoise Héritier, 275–323. Paris: Odile Jacob.
- Niarchos, Catherine. 1995. "Women, War, and Rape: Challenges Facing the International Tribunal for the Former Yugoslavia", *Human Rights Quarterly* 17 (4): 649–690.
- Olujić, Maria. 1998. "Embodiment of Terror: Gendered Violence in Peacetime and Wartime in Croatia and Bosnia-Herzegovina", *Medical Anthropology Quarterly* 12 (1): 31–50.
- Rejali, Darius. 1996. "After Feminist Analyses of Bosnian Violence", *Peace Review* 8 (3): 365–371.
- Robinson, Darryl. 1998. "Trials, Tribulations, and Triumphs: Major Developments in 1997 at the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia", *Canadian Yearbook of International Law* 35: 179–213.
- Ross, Fiona. 2010. "An Acknowledged Failure: Women, Voice, Violence and the South African Truth and Reconciliation Commission". Në *Localizing transitional justice: Interventions and priorities after mass violence*, përg. Rosalind Shaw

- dhe Lars Waldorf, 69-91. Stanford: Stanford University Press.
- Sanday, Peggy Reeves. 1981. "The Socio-Cultural Context of Rape: A Cross-Cultural Study", *Journal of Social Issues* 37 (4): 5–27.
- Sharlach, Lisa. 2000. "Rape as Genocide: Bangladesh, the former Yugoslavia, and Rwanda", *New Political Science* 22 (1): 89–102.
- Seifert, Ruth. 2002. "The Female Body as a Symbol and a Sign: Gender-Specific Violence and the Cultural Construction of War". Në *War or Health? A reader*, përg. Ilka Taipale. London: Zed Books.
- Sells, Michael. 1996. *The Bridge Betrayed: Religion and Genocide in Bosnia*. Berkeley: University of California Press.
- Sjoberg, Laura. përg. 2010. *Gender and International Security: Feminist Perspectives*. London; New York: Routledge.
- Subotic, Gordana dhe Adriana Zaharijevic. 2017. "Women between War Scylla and Nationalist Charybdis: Legal Interpretations of Sexual Violence in Countries of Former Yugoslavia", Në *Gender in Human Rights and Transitional Justice*, përg. John Idriss Lahai dhe Khanyisela Moyo. New York: Palgrave-Macmillan.
- Tompkins, Tamara. 1995. "Prosecuting Rape as a War Crime: Speaking the Unspeakable", *Notre Dame Law Review* 70 (4): 845–890.
- Weitsman, Patricia. 2008. "The Politics of Identity and Sexual Violence: A Review of Bosnia and Rwanda", *Human Rights Quarterly* 30 (3): 561–578.
- Wood, Elisabeth. 2006. "Variation in Sexual Violence during War", *Politics and Society* 34 (3): 307–320.
- Zarkov, Dubravka. 2007. *The Body of War: Media, Ethnicity and Gender in the Break-up of Yugoslavia*. Durham: Duke University Press.